

VENDIM
Nr. 430, datë 15.7.2021

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
VLORE, TË PRONËS NR. 1186, ME EMËRTIM “HANGARË AVIONËSH”, ME
VENDNDODHJE NË VLORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të pronës nr. 1186, me emërtim “Hangarë avionësh”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një tregu publik në Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1186, me emërtim “Hangarë avionësh”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planrilevimit, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Vlorë.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

Prona nr. 1186 "Hangar Avionash" Vlorë

PRONARI SHTET MM (Forca Ajrore) DATË 15/04/2021 QËLLIMI Transferim te Bashkia Vlorë

VENDNDODHJA

Bashkia Vlorë DVASHK/ZVASHK Vlorë Nr.Pasurisë 3/29, 2/190 Z.K 8605 Indeksi i Hartës VL -E-10

TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë _____ Sip e pasurisë 6 227.7m² Sip e gjurmës së ndërtimit 2 648.94m² Nr. kateve _____ Nr. pemeve _____

Nord = 4483157.57
East = 455684.85

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4483157.57
East = 455860.81



SHPJEGUESE:

Kufiri sipas gjendjes faktike _____
Sipërfaqja = 6 227.7m²

Nord = 4483017.14
East = 455684.85

SH 1: 1000

Nord = 4483017.14
East = 455860.81

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI	KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri					
2	Lindje					K51726024H
3	Jug					
4	Perëndim					

REALIZOI PËR IGJIU
Topograf Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti _____
DVASHK _____
Nënshkrimi _____
KONFIRMOI _____
Përgjegjësi/Drejtori _____
Nënshkrimi/ Vula _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT P-Përfaqësuesi i Forcës Ajrore; HK-Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA: Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës të Komandës të Forcës Ajrore nr.353/1, datë 02.02.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJIU-së dhe sipas HTR.

PRONARI: FORCA AJRORE

MIRATOHET
ZV/KOMANDANTI I FORCËS AJRORE
Kolonel Ylli PULAJ